

# Inspektori i Lartë i Drejtësisë

## BULETINI MUJOR

Nr.14

# Mars 2022



### INSPEKTORI I LARTË I DREJTËSISË NËNSHKRUAN MARRËVESHJE BASHKËPUNIMI ME 6 ORGANIZATA TË SHOQËRISË CIVILE

Vendosja e një komunikimi të vazhdueshëm mes shoqërisë civile dhe Zyrës së ILD-së, u formalizua përmes nënshkrimit të një marrëveshjeje bashkëpunimi mes Inspektorit të Lartë të Drejtësisë Z. Artur Metani dhe gjashtë organizatave të shoqërisë civile (OSHC), që kanë pjesë të punës së tyre monitorimin e reformës në drejtësi, e të drejtave të njeriut, transparencën, llogaridhënien e mirëqeverisjen.

Bashkëpunimi i nisur më herët me shoqërinë civile, përmes konsultimit për Planin Strategjik e

Planin e Veprimit të ILD-së 2020-2022, materializohet me këtë marrëveshje, të nënshkruar në datën 16 Mars, e cila synon rritjen e performancës dhe ngritjen e kapaciteteve të Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, përmes rritjes së komunikimit dhe zhvillimit të aktiviteteve të përbashkëta, në kuadër të monitorimit, analizimit, procesit llogaridhënës dhe ndërgjegjësues mbi veprimtarinë e Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, përmes shkëmbimit të të dhënave, organizimit të takimeve periodike, ofrimit të ekspertizës përkatëse të *(vijon)*



**ILD**  
INSPEKTORI I LARTË  
I DREJTËSISË

### NGA MARRËVESHJA

Qëllimi i bashkëpunimit është vendosja e komunikimit në vijimësi mes shoqërisë civile dhe Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, përmes proceseve transparente të monitorimit të veprimtarisë dhe rritjes së besimit të publikut, në drejtim të ndërgjegjësimit të opinionit publik mbi misionin, kompetencat dhe përgjegjësitë e ILD. Palët me synim rritjen e performancës dhe ngritjen e kapaciteteve nëpërmjet kësaj marrëveshjeje angazhohen në rritjen e komunikimit dhe zhvillimin e një sërë aktiviteteve të përbashkëta, përmes shkëmbimit të të dhënave, organizimit të takimeve periodike, ofrimit të ekspertizës përkatëse të OSHC-ve të specializuara, apo think-tank.

OSHC-ve të specializuara.

Marrëveshja me ILD-në u nënshkrua nga Instituti për Studime Publike e Ligjore (ISPL), përfaqësuar nga Z. Ardian Dhima; Instituti i Studimeve Politike (ISP), përfaqësuar nga Z. Afrim Krasniqi; Instituti për Bashkëpunim dhe Zhvillim (IBZH), përfaqësuar nga Znj. Krisela Hackaj; Komiteti Shqiptar i Helsinkit (KSHH), përfaqësuar nga Znj. Erida Skëndaj; Qendra Europiane (QE), përfaqësuar nga znj. Klara Kodra dhe Instituti Shqiptar i Shkencës/Open Data Albania, përfaqësuar nga Znj. Aranita Brahaj.



Gjatë ceremonisë së nënshkrimit të marrëveshjes, Inspektori i Lartë i Drejtësisë Z. Metani vlerësoi rolin e rëndësishëm të organizatave të shoqërisë civile në forcimin e proceseve demokratike dhe nënvizoi se ky mekanizëm bashkëpunimi institucional do t'i shërbejë përmirësimit të punës së ILD-së, e më tej gjithë sistemit për funksionimin e një sistemi drejtësie profesional, të përgjegjshëm, llogaridhënës dhe transparent.

[Kliko](#) për të lexuar Marrëveshjen.

---

## **INSPEKTIMI DHE HETIMI DISIPLINOR, ILD NËNSHKRUAN MARRËVESHJE BASHKËPUNIMI ME HOMOLOGËT ITALIANË**

---



Gjatë një vizite pune në Romë, Inspektori i Lartë i Drejtësisë Z. Artur Metani zhvilloi një takim në Ministrinë e Drejtësisë së Italisë, ku nënshkroi një memorandum mirëkuptimi me drejtuesen e Inspektoratit të Përgjithshëm të Drejtësisë së Italisë, Znj. Maria Rosaria Covelli, me synim fuqizimin e marrëdhënieve ndërinstytucionale dhe shkëmbimin e praktikave më të mira, në kuadër të procedurave të inspektimit dhe hetimit disiplinor ndaj magjistratëve.

Në fjalën përshëndetëse gjatë ceremonisë së nënshkrimit, Zoti Metani vërejti se shtete të ndryshme anëtare të Bashkimit Evropian, si Italia vite më parë apo vende aspirante si Shqipëria, i janë nënshtruar evolucionit dhe reformave të thella, lidhur me sistemin e drejtësisë në përgjithësi dhe sistemit disiplinor të magjistratëve në veçanti.



*“Kompetencat që u janë besuar magjistratëve janë të*


*lidhura ngushtë me vlerat e drejtësisë. Standardet e sjelljes që zbatohen për magjistratët janë rrjedhojë e këtyre vlerave dhe një parakusht për besimin e qytetarëve në dhënien e drejtësisë. Pavarësisht dallimeve ndërmjet sistemeve disiplinore të shteteve të ndryshme, në nivel evropian ekziston një qëllim i përbashkët, i cili është gjetja e një ekuilibri midis pavarësisë së sistemit gjyqësor ose autoritetit të vendimeve të magjistratëve dhe përgjegjësisë disiplinore. Kjo është tashmë sfida e të gjithëve ne.”*, tha Z. Metani.

Pas nënshkrimit të marrëveshjes, Znj. Maria Rosaria Covelli tha se Inspektorati Italian e pranoi me entuziazëm ftesën e homologut shqiptar, me sigurinë se bashkëpunimi i zyrtarizuar me këtë memorandum do jetë një vlerë e shtuar e ndërsjelltë, që do konsolidojë edhe më tej marrëdhëniet tashmë të shkëlqyera që Italia ka me Shqipërinë.

Mes formave të bashkëpunimit, në nenin 2 të Memorandumit, parashikohet shkëmbimi i informacionit mbi praktika dhe eksperiencia të lidhura me hetimet disiplinore ndaj magjistratëve, mbi metodologjinë e inspektimeve dhe përgatitjen e planeve vjetore si dhe mbi modalitetet e komunikimit me publikun, me synim garantimin e një ekuilibri mes parimit të një drejtësie të hapur dhe parimit të mbrojtjes së të dhënave personale.

Nga ana e saj, Ministrja e Drejtësisë Znj. Marta Cartabia, ka nënvizuar rëndësinë e kësaj marrëveshjeje në kuadër të marrëdhënieve të bashkëpunimit mes Italisë e Shqipërisë.

**Si Pranohen Ankesat**



**NJOFTIM**

Për të lehtësuar edhe më shumë procesin e ankimit, Zyra e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë sjell një formë të re, më të thjeshtuar të ankesës, që qytetarët apo institucionet mund të paraqesin për shkelje të dyshuara nga ana e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Shqipëri.

Ky shtetim shpërgjose i procedurës shoqërohet me shembuj konkretë të vendimeve të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë për secilin nga kriteret të përcaktuara në lig mbi pranueshmërinë dhe shqyrtimin e ankesave.

Për më shumë informacion, ju lutem klikoni këtu.

Faqe

**ANKIMIMI NË ILD**

Zyra e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë vijon me intensitet punën për konfirmimin e ankesave të mbartura e atyre të administruara që prej 1 Shkurtit 2020, kur u ngrit si institucion. Për të lehtësuar këtë proces për personat e interesuar, ILD ka të publikuar në faqen zyrtare një formular të posaçëm ankesë, i cili:

- ⇒ mund të plotësohet direkt dhe dërgohet online;
- ⇒ të shkarkohet, plotësohet e dërgohet me email në [info@ild.al](mailto:info@ild.al)
- ⇒ ose me postë në adresën Bulevardi “Dëshmorët

e Kombit”, Godina nr.13, Tiranë.

⇒ mund të plotësohet pranë Zyrës së ILD, në rast nevojë, me asistencën e ekipit të zyrës së ankesave.

Pas marrjes së ankesës, Inspektori i Lartë i Drejtësisë Brenda 5 ditëve konfirmon me shkresë marrjen e saj.

Kriteret e pranueshmërisë së ankesës gjenden të publikuara në faqen zyrtare të ILD-së [www.ild.al](http://www.ild.al), në seksionin “Si pranohen ankesat”.


*“Angazhimi kryesor i institucionit të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë është ushtrimi i funksioneve gjyqësore në Republikën e Shqipërisë në mënyrë sa më të pavarur, të paanshme dhe me integritet nëpërmjet një sistemi përgjegjshmërie dhe llogaridhënie.”*

**STATISTIKA**

Gjatë muajit **Mars** Zyra e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë ka administruar **69 ankesa** të cilat janë paraqitur nga qytetarë dhe institucione.

**Konkretisht: 68 ankesa** janë depozituar nga qytetarët; **1 ankesë** është përcjellë nga një institucion; **34 telefonata** me qytetarë, të cilët kanë kërkuar informacion mbi fazën e ankesave të tyre ose informacion mbi plotësimin e formularit TIP të ankesës; **25 takime me ankesues.**

Zyra e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë ka kryer konfirmimin standard të marrjes së ankesës për të gjitha ankesat, që kanë hyrë për herë të parë në institucion gjatë muajit Mars 2022. Ankesat që kanë subjekt të tyre prokurorë dhe gjyqtarë janë shpërndarë tek Inspektorët dhe ndodhen në faza të ndryshme, si shqyrtim fillestar, arkivim, verifikim, me projektvendimet përkatëse.





## PRITJA E QYTETARËVE NË ILD

Komunikimi me qytetarët është pjesë e punës së përditshme të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë. Sektori i ankesave në ILD është përgjegjës për garantimin e të drejtës së informimit të qytetarëve dhe transparencën ndaj publikut. Ky sektor ndjek gjurmueshmërinë e ankesave në sistem dhe jep përgjigje për ankuesit, mbi fazën ku ndodhet ankesa e tyre.

Ekipi i zyrës së ankesave pret qytetarë-ankues cdo ditë pune nga ora 09.00-14.00, ndërsa për një komunikim të shtuar me qytetarët e interesuar, krahas komunikimit përmes faqes dhe adresës zyrtare, Zyra e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë ka vënë në dispozicion numrin e telefonit +355 4 2217217.



## MARSI I ILD

### NË SHIFRA

**95 vendime arkivimi**  
nga të cilat:

- **65** vendime pas shqyrtimit fillestar,
- **10** vendime arkivimi pas verifikimit (ILD),
- **20** vendime arkivimi pas verifikimit nga dosje të mbartura nga KLD.
- **21 vendime verifikimi** nga 26 ankesa të shqyrtuara,
- **1 vendim** për fillim hetimi disiplinor
- **1 vendim** për mbyllje hetimi për 3 subjekte.

---

## ZYRA E INSPEKTORIT TË LARTË TË DREJTËSISË DORËZON NË KUVEND RAPORTIN E PUNËS PËR VITIN 2021

---

Raportimi i punës një vjecare është pjesë e detyrimit që institucionet e pavarura kushtetuese si Inspektori i Lartë i Drejtësisë kanë detyrimin paraqesin në Kuvend raportin vjetor të veprimtarisë së tyre si dhe nivelin e zbatimit të rekomandimeve të rezolutës së Kuvendit për Institucionin.

### MESAZHI I INSPEKTORIT TË LARTË TË DREJTËSISË



Të nderuar deputetë,

Është hera e dytë që kam kënaqësinë të ndaj me Kuvendin përmes raportimit vjetor, ecurinë e punës së Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, tani për vitin kalendarik 2021. Në dy vite jetë të ILD-së, u mësua me vështirësitë e ngritjes dhe normimit të veprimtarisë së një institucioni krejtësisht të ri.

Na ka ndodhur, që më shpesh udhëhiqeshim nga sfidat, sesa t'i udhëhiqnim ato!

Në dy vitet që lamë pas, bëmë gjithçka në emër të ndërtimit të praktikave të punës dhe të sigurimit të rezultatit maksimal, pa paragjykimet dhe pa u lodhur, në misionin që i kemi vënë vetes.

Sot jemi të vetëdijshëm se duhet të nisim një kapitull të ri, sepse sfida më e madhe është ende aty! Është një sfidë e cila nuk kapërcehet dot vetëm, sepse është sfida e rikthimit të besimit tek Drejtësia.

Me këtë synim, siç do e shikoni në këtë raport, kemi patur në fokus qytetarët, orientimin e tyre tek procesi i ankimimit në ILD, kur kanë pretendime për gjyqtarë e prokurorë. Për mua si Inspektor i Lartë i Drejtësisë, besimi në drejtësi lexohet sidomos kur i drejtohesh institucioneve dhe numri i ankesave në rritje pranë institucionit tonë, e tregon këtë.

4127 është totali i ankesave të administruara në ILD për vitin 2021. Një shifër impresionuese, që përbëhet nga stoku i trashëguar nga institucione të tjera dhe ankesa të reja të ardhura direkt në ILD. Për trajtimin e stokut të trashëguar, po punohet sipas një metodologjie, që ka prioritet shmangien kulturës së pandëshkueshmërisë dhe harresës, përmes vendosjes në prioritet trajtimi, të ankesave dhe praktikave që janë brenda afatit 5 vjeçar të parashkrimit dhe atyre që kanë si subjekt magjistratët në detyrë. Natyrisht, puna vijon edhe me trajtimin e ankesave të reja, atyre të ardhura direkt në ILD.

---

**“I gjithë ky proces realizohet me vetëm 8 Inspektorë, nga 1 që kishim në vitin e parë të punës, por ende larg numrit të nevojshëm për të përballuar vëllimin e madh të punës. Plotësimi i kapaciteteve të hetimit mbetet një sfidë edhe në vazhdim, ndërsa ILD do bëjë pjesën e vet përmes rekrutimit të inspektorëve jo magjistratë.”**

---

Procedimi disiplinor është momenti final i punës, të cilit i kushtohet vëmendje e posaçme sepse nuk ka si qëllim parësor thjesht ndëshkimin e magjistratëve, por edhe edukimin e tyre mbi rëndësinë që ka profesionalizmi e integriteti i magjistratit, për besimin e publikut tek drejtësia.

---

**“Vetëm gjatë vitit 2021 janë 22 vendime për fillimin e hetimit disiplinor të miratuara nga ILD për 31 subjekte të hetimit disiplinor. Nga këto, 17 raste kanë shkuar për procedim disiplinor në Këshilla, ndërsa për 4 janë mbyllur hetimet. Nga 17 kërkesa për procedim disiplinor, 10 janë hetim me iniciativë nga Inspektori i Lartë dhe 7 janë rezultat i hetimit të ankesave të depozituara. Vetë inspektimet tematike kanë prodhuar 3 procedime disiplinore, 2 prej të cilave gjatë 2020 dhe 1 gjatë vitit 2021. Masat e kërkuara për gjyqtarët e prokurorët e proceduar shkojnë nga vërejtje konfidenciale deri në shkarkim nga detyra. Nga 17 kërkesat për procedim të përcjella në Këshilla, asnjë kërkesë nuk është rrëzuar, dhe vetëm për 2 kërkesa është vendosur një masë tjetër disiplinore, meritë edhe e punës skrupuloze të ekipit të Inspektorëve të Zyrës së ILD-së, pavarësisht mungesës së 18 inspektorëve dhe ngarkesës së 8 Inspektorëve në detyrë.”**

---

Viti 2021 është shenjuar për ILD-në nga rritja e bashkëpunimit me aktorë kombëtarë, ndërkombëtarë dhe shoqërinë civile, e cila është një monitoruese nga afër e punës së ILD-së.

Bashkëpunimi me KLGJ-në e KLP-në ka qenë i rëndësishëm në koordinimin e standardeve uniforme për garantimit të një procesi të rregullt disiplinor e në respekt të pavarësisë së magjistratëve, njëlloj edhe shkëmbimi i informacionit ndërinstitucional.

Duke qenë një institucion krejt i ri, ILD ka patur vëmendje të shtuar për ngritjen dhe fuqizimin e kapaciteteve profesionale të hetimit, përmes shkëmbimi i praktikave më të mira në lidhje me procedurat e hetimit të shkeljeve disiplinore ndaj magjistratëve. E kemi nisur këtë rrugëtim me miq të mirë, partnerë ndërkombëtarë nga EURALIUS e OPDAT, tek CEPEJ e deri tek Rrjeti European i Shërbimeve të Inspektimit të Drejtësisë, ku tashmë Inspektori i Lartë i Drejtësisë mban statusin e vëzhguesit, në një Rrjet ku anëtarët janë vetëm nga vende të Bashkimit Europian.

Gjatë vitit 2021 ILD i ka kushtuar vëmendje të posaçme dhe ka përmbushur pjesën më të madhe të rekomandimeve të Rezolutës së Kuvendit, miratuar më 03.06.2020, me gjithë vështirësitë subjektive me të cilat është përballur.

Me gjithë sfidat, transparencën me publikun e konsiderojmë pikë të fortë të institucionit, pasi ILD e sheh marrëdhënien me publikun si një nga mënyrat më efektive, jo vetëm për të garantuar besimin e qytetarëve tek institucioni në veçanti, por edhe tek drejtësia në përgjithësi. Ishte pikërisht kjo fryma me të cilën u konceptua reforma në drejtësi dhe ILD në këto dy vite jetë po luan një rol të rëndësishëm në këtë drejtim, përmes rezultateve të matshme.

Personalisht mendoj se nuk ka një tjetër kohë më të përshtatshme për të gjithë ne, për ta shndërruar drejtësinë në atë që meriton çdo shqiptar: në virtytin ku secili të mund të mbështetet, e ku secilit do të duhet që t'i shërbehet drejtësi. Kjo sigurisht që kërkon sakrificë! Dhe këto sakrificë kërkojnë zemër, kërkojnë mendje të kthjellët, kërkojnë bashkëpunim, vlerësim dhe respekt institucional. Por ne sot duhet të bëjmë gjithçka në emër të asaj, që një ditë mund të bëhet e mira jonë e përbashkët: “Drejtësia e Pavarur”!

Këtë filozofi do gjeni në veprimtarinë e ILD-së, e përmbledhur në raportin vjetor për vitin 2021, i paraqitur para jush!

## NGA PROCESI I ANKESAVE GJATË VITIT 2021

Nga analiza e të dhënave statistikore të ankesave të administruara nga Zyra e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë dallohen disa specifikime. Analizimi i këtyre të dhënave është parë me dobi në funksion të hartimit të politikave të brendshme të punës, jo vetëm për të përmirësuar shërbimin në funksion të interesit publik dhe transparencës, por edhe kuptimit më të mirë të individit që paraqet ankesë dhe zhvillimin e politikave ndërgjegjësuere në këtë drejtim.

Kështu referuar të dhënave të grumbulluara për subjektet që vënë në lëvizje Inspektorin e Lartë të Drejtësisë, nga 990 vendimet e arkivimit, është bërë kategorizimi i të dhënave, sipas kategorisë së subjekteve, të ndara në “person fizik” dhe “juridik”.

Nga **990 vendime arkivimi**:

⇒**945** prej tyre, janë marrë pas shqyrtimit të ankesave të individëve;

⇒**41** vendime arkivimi janë marrë pas shqyrtimit të ankesës së paraqitur, nga persona juridikë;

⇒**4** prej tyre janë marrë pas shqyrtimit të ankesave që vijnë nga media.

### SHPËRNDARJA GJEOGRAFIKE E ANKUESVE

Tiranë	375
Vlorë	70
Durrës	66
Fier	66
Lezhë	57
Korçë	57
Shkodër	51

Një dukuri tjetër e analizuar ka qenë shpërndarja gjeografike e ankuesve, prej së cilës rezulton se: **Tirana është qarku me numrin më të lartë të ankuesve, ndërsa Shkodra ka numrin më të ulët.**

Të dhënat tregojnë se për kategorinë e vendimeve të arkivimit; për **48 raste**, ankesat kanë ardhur nga ankues të cilët kanë si vendbanim të regjistruar institucionet e ekzekutimit të vendimeve penale. Për **18** prej ankuesve nuk është treguar adresa, **14** prej ankuesve janë me adresë të regjistruar jashtë kufijve të Shqipërisë dhe **6** prej tyre kanë përcjellë ankesat e tyre përmes postës elektronike, pa përcaktuar adresë.

Për ankesat e paraqitura nga individë, janë grumbulluar edhe dy tregues të tjerë, atë të gjinisë dhe grup-moshës së ankuesve.

### GRUPMOSHA E ANKUESVE

20-30 vjeç	19
30-40 vjeç	102
40-50 vjeç	186
50-60 vjeç	290
Mbi 60 vjeç	386

Nga të dhënat e grumbulluara, rezulton se nga ankesat e shqyrtuara, **626** ankues i përkasin kategorisë “meshkuj” dhe **226** ankues i përkasin kategorisë “femra”.

Sa i takon grup-moshës, për ankesat e paraqitura nga individë, **numri më i lartë i ankuesve** i takon grupmoshës **mbi 60 vjeç**, ndërsa më pak ankohen individët e grupmoshës 20-30 vjeç.


Shkeljet e pretenduara janë analizuar gjithashtu si të dhëna të nxjerra nga pretendimet e ankuesve në ankesat e depozituara gjatë vitit 2021 për shkelje disiplinore të subjektit të hetimit disiplinor. **Ankesat vijnë më shumë për gjyqtarë se për prokurorë**, ndërsa lloji i shkeljes së pretenduar lidhet më shumë me veprimtarinë e magjistratëve gjatë ushtrimit të detyrës, kjo pasi të gjithë subjektet ankues kanë pasur çështjet për gjykim apo nën hetim nga



gjykatat apo prokuroritë. Ajo që vihet re është fakti se ankesat më të shumta i referohen shkeljeve me objekt vendimmarrje të padrejta të magjistratëve gjatë shqyrtimit të një çështjeje, shkelje procedurale dhe zvarritje të procesit gjyqësor/hetimor.


Sa i përket ankesave të trajtuara me vendim arkivimi ka rezultuar se ankuesit më shumë pretendime kanë ngritur ndaj magjistratëve të këtyre gjykatave:

- ⇒ Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë (124 ankesa);
- ⇒ Gjykata e Apelit Tiranë (60 ankesa);
- ⇒ Gjykata e Rrethit Gjyqësor Durrës (45 ankesa);
- ⇒ Gjykata e Rrethit Gjyqësor Shkodër (42 ankesa);
- ⇒ Gjykata e Apelit Vlorë (38 ankesa);
- ⇒ Gjykata e Rrethit Gjyqësor Fier (35 ankesa);
- ⇒ Gjykata e Rrethit Gjyqësor Korçë (28 ankesa);
- ⇒ Gjykata e Rrethit Gjyqësor Vlorë (28 ankesa);



Ndërsa për sa i takon, ankesave të trajtuara me vendim arkivimi ka rezultuar se ankuesit më shumë pretendime kanë ngritur ndaj këtyre prokurorive:

- ⇒ Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Tiranë (124 ankesa);
- ⇒ Prokuroria pranë Gjykatës së Apelit Tiranë (60 ankesa);
- ⇒ Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Durrës (23 ankesa);
- ⇒ Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Fier (21 ankesa);
- ⇒ Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Vlorë (21 ankesa);
- ⇒ Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Gjirokastrë (14 ankesa);



### Ankesat e trajtuara, sipas objektit të padisë

Nga informacioni i gjeneruar në Zyrën e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë është identifikuar lloji i procesit gjyqësor/objektit të padisë së shqyrtuar nga ana e magjistratit, ndaj të cilit ngrihen pretendime. Nga ankesat e trajtuara gjatë vitit 2021, rezultojnë **më shumë pretendime për çështje penale** se civile; **lloji më i shpeshtë i veprës penale** të denoncuar është **falsifikimi**; ndërsa **objekti më i shpeshtë i padisë civile** është për çështje të pronësisë.

Evidentimi i këtyrë të dhënave konsiderohet si tregues që lidhet ngushtësisht me kuptimin e misionit të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë nga publiku i gjerë. Është një ndër përparësitë që ka Inspektori i Lartë, në drejtim të rritjes së ndërgjegjësimit të publikut mbi misionin e veprimtarisë së ILD-së. Të dhënat e përfuara i shërbejnë hartimit të politikave në këtë fushë me synim thjeshtimin dhe kuptimin e drejtë të misionit të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë. Rritja e ndërgjegjësimit të publikut është premisë për krijimin e lehtësirave në minimizimin e fluksit të ankesave, të cilat janë jashtë objektit të veprimtarisë, apo janë të papranueshme për shkak të mos përmbushjes së kriterëve ligjore. Nga ana tjetër, evidentimi i të dhënave i shërben nevojave për përmirësim, qoftë në nivel dhënie shërbimi, por edhe të kuptuarit nëse ndërgjegjësimi ka arritur të përmbushë qëllimin e tij, atë të thjeshtimit dhe edukimit të publikut, në drejtim të kuptimit të drejtë të sjelljeve, që i japin shkak procedimit disiplinor nga Inspektori i Lartë i Drejtësisë.

## ILD MIRËKUPTON NGARKESËN E MAGJISTRATËVE POR NUK DO TOLEROJË PALIGJSHMËRINË

Inspektori i Lartë i Drejtësisë ka dhënë një intervistë për gazetaren Anila Hoxha të Top Channel, mbi ecurinë e procesit të ankimit ndaj magjistratëve dhe punën e ILD-së në dy vite, që nga ngritja si institucion.



I pyetur se përse ankohen më shumë qytetarët pranë ILD-së dhe nga cilat qytete, Z. Metani tha se janë rreth 4500 ankesa të administruara, por nga ato të trajtuara, më shumë pretendime ka për zvarritje të procedurave gjyqësore nga magjistratët dhe në statistikën e ILD-së, rrethet me më shumë ankues rezultojnë Tirana dhe Vlora.

*“Ajo që po vërejmë sot me shqetësim dhe dua ta ndaj me ju është vonesa në zbardhjen e vendimeve gjyqësore. Pra, pasi ka përfunduar procesi gjyqësor, zbardhja e vendimit merr shumë kohë. Kjo vjen për shumë arsye dhe ne po mundohemi të balancojmë këtë situatë, edhe me ngarkesën e madhe që kanë magjistratët, edhe me mungesën e magjistratëve në sistem për shkak të proceseve të tjera që po ndodhin në Shqipëri për shkak të reformës, edhe për arsye të kompleksitetit të çështjeve, sigurisht duke e balancuar këtë edhe me raste të neglizhencës së gjyqtarëve kur ka, apo me raste të performancës së dobët profesionale të gjyqtarëve. Për këtë ne kemi marrë edhe masa. Kemi proceduar edhe magjistratë për vonesën në zbardhjen e vendimeve. Po gjithsesi, gjetja e balancës së drejtë midis shpejtësisë së zbardhjes së vendimeve dhe vonesave të pajustificuara për shkak të neglizhencës së gjyqtarëve, por edhe mos prekjes së cilësisë së shkrimit të vendimeve, është një gjë që po e shohim me prioritet dhe i bëj thirrje të gjithë gjyqtarëve dhe prokurorëve, që të kenë kujdes në këto procedura. Të mos ketë vonesa, por edhe pa prekjen e cilësisë së shkrimeve të vendimeve sepse kjo padyshim është shumë e rëndësishme.”*, u shpreh Inspektori i Lartë i Drejtësisë.

I pyetur nga gazetarja se çfarë ka konstatuar lidhur me prioritetin e shpallur që në marrje të detyrës, atë të lirimeve me kusht të personave të dënuar me burgim të përjetshëm, Z. Metani tha:

*“Në momentin që është zgjedhur Inspektori i Lartë i Drejtësisë në janar të vitit 2020, pa dyshim ky ishte sensibiliteti më i madh i shoqërisë në atë kohë, sepse pati disa raste të lirimit para kohe me kusht të disa individëve nga institucionet e burgimit dhe për këtë arsye, vendimi i parë që mori Inspektori i Lartë i Drejtësisë në atë kohë, ishte inspektimi i dosjeve të lirimit para kohe me kusht, në kuadër të një inspektimi të madh tematik sepse u prekën të gjitha gjykatat dhe prokuroritë ku ka institucione paraburgimi dhe burgimi. Ne propozuam disa masa. Ndër to ishin edhe masat për shkarkimin e 3 magjistratëve. Këto masa vazhdojnë edhe sot, sepse ka magjistratë që i kemi nën hetim. Një hetim është përfunduar dhe është dërguar për procedim në KLGJ. Kështu që është një gjë, që ne e kemi parë me shumë vëmendje. Nuk është as për ta evidentuar si sukses, nuk është as për ta evidentuar me ndonjë konsideratë. Është një proces normal pune i ILD-së dhe është mesazh i qartë për këdo magjistrat, që ILD nuk është një çekan mbi kokat e tyre, por nuk do tolerohet asnjë paligjshmëri nga ana e magjistratëve. Këtë e kam thënë që në intervistën e parë dhe këmbëngul ta them përsëri.”*

Inspektori i Lartë Z. Metani ka folur edhe për sfidën me dosjet e trashëguara nga ish KLD, KLGJ, Prokurori i

Përgjithshëm e Ministria e Drejtësisë, të cilat duhen trajtuar nga ILD në kushtet e mungesave në inspektorë.

*“Të gjithë inspektorët po i trajtojnë me prioritet, që të mos kalojnë afatet apo të digjen ankesat për shkak të kalimit të afatit, të parashkrimit. Por, kjo është një gjë që po ndodh, në kuptimin që ne po mundohemi të trajtojmë çdo ankesë, por është një ngarkesë e madhe, që s’e përballojmë dot, pra trajtimi i ankesave në kohë. E dyta, duan zgjidhje qytetarët, pra e kanë paraqitur ankesën para 5 viteve dhe nuk është normale për një institucion publik, të mos i kthejë një përgjigje qytetarit, të paktën pas 5 viteve. E treta, që është e rëndësishme gjithashtu, jam munduar, edhe pse janë ankesa të vjetra, të procedojmë magjistratë edhe për këto ankesa të vjetra, për t’i kujtuar kujtudo, që nuk harrohet asgjë.”*, nënvizoi Z. Metani.

### **Intervista e plotë e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë Z. Artur Metani dhënë gazetares Anila Hoxha, për televizionin Top Channel**

**Gazetarja Anila Hoxha:** Si fillim, faleminderit. Nga inspektimet që janë kryer por referuar edhe ankesave të qytetarëve drejtuar në ILD, për çfarë janë ankuar më së tepërmi shtetasit shqiptarë? Më shumë për gjyqtarët apo më tepër për prokurorët dhe a ka një shifër për diçka të tillë?

**Inspektori i Lartë i Drejtësisë, Z. Artur Metani:** Faleminderit për intervistën. Për të qenë konkret me pyetjen tuaj, numri i ankesave të ardhura në institucionin e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë sot është rreth 4500 ankesa. Këtu përfshihen ankesa të ardhura nga viti 2020, në momentin që është zgjedhur Inspektori i Lartë i Drejtësisë, por përfshihen edhe ankesat e ardhura, të prapambetura apo backlog siç quhen, nga institucione të tjera; Këshilli i Lartë Gjyqësor, Këshilli i Lartë i Drejtësisë, Prokurori i Përgjithshëm dhe Ministria e Drejtësisë. Numri i ankesave është parë e vazhdon të shihet dhe trajtohet me prioritet. Sot që flasim janë trajtuar rreth 1700 ankesa nga ky grup i madh. Numri i ankesave vijon të rritet shumë. Nga Tetori i vitit të kaluar deri sot numri i ankesave është shtuar në mënyrë të konsiderueshme. Pra, në këto 4-5 muaj ka rreth 800 ankesa që kanë ardhur. Është një tregues për t’u marrë në konsideratë, i cili tregon reflektimin e shoqërisë, për problemin që ka sistemi gjyqësor sot dhe sistemi i prokurorisë, por edhe ndoshta efikasitetin e institucioneve të reja të drejtësisë, që po funksionojnë, siç është Inspektorit i Lartë të Drejtësisë apo edhe Këshillat përkatës, kur referojnë apo kur trajtojnë edhe ato ankesat e qytetarëve. Ankesat e qytetarëve fokusohen përgjithësisht në zvarritje të procedurave gjyqësore apo të dosjeve hetimore nga prokuroria, në njëanshmëri të vendimmarrjeve nga gjykatat, në veprime apo mosveprime të prokurorëve në çështje të caktuara. Numri më i madh i ankesave është për gjyqtarët dhe jo për prokurorët. Por, ajo që po vërejmë sot me shqetësim dhe dua ta ndaj me ju është vonesa në zbardhjen e vendimeve gjyqësore. Pra, pasi ka përfunduar procesi gjyqësor, zbardhja e vendimit merr shumë kohë. Kjo vjen për shumë arsye dhe ne po mundohemi të balancojmë këtë situatë, edhe me ngarkesën e madhe që kanë magjistratët, edhe me mungesën e magjistratëve në sistem për shkak të proceseve të tjera që po ndodhin në Shqipëri, për shkak të reformës, edhe për arsye të kompleksitetit të çështjeve, sigurisht duke e balancuar këtë, edhe me raste të neglizhencës së gjyqtarëve kur ka, apo me raste të performancës së dobët profesionale të gjyqtarëve. Për këtë ne kemi marrë edhe masa. Kemi proceduar edhe magjistratë për vonesën në zbardhjen e vendimeve. Por, doja të evidentoja që kjo është një balancë e kujdesshme, që duhet bërë jo thjesht për vonesat që mund të kenë gjyqtarët në zbardhjen e vendimeve, por kjo vonesë të mos prekë as cilësinë e vendimmarrjes, sepse duke pasur ngarkesën, por duke patur edhe presionin që vendimet të zbardhen shpejt, shpesh mund të ndodhë, që mund të bjerë edhe cilësia e shkrimit të vendimeve. Natyrisht, ne s’e duam këtë. Po

gjithsesi, gjetja e balancës së drejtë midis shpejtësisë së zbardhjes së vendimeve dhe vonesave të pajustificuara për shkak të neglizhencës së gjyqtarëve, por edhe mos prekjes së cilësisë së shkrimit të vendimeve, është një gjë që po e shohim me prioritet dhe i bëj thirrje të gjithë gjyqtarëve dhe prokurorëve, që të kenë kujdes në këto procedura. Të mos ketë vonesa, por edhe pa prekjen e cilësisë së shkrimeve të vendimeve sepse kjo pa dyshim është shumë e rëndësishme.

**Gazetarja Anila Hoxha:** Nga cilat qytete kanë ardhur më së tepërmi ankesa, nëse do t'i ndanim ose do t'i rendisnim?

**Inspektori i Lartë i Drejtësisë, Z. Artur Metani:** Po, numri më i madh i ankesave vjen nga Tirana, rreth 600 e disa, më pas Vlora, më pas është Durrësi, Fieri, ka dhe Shkodra dhe pastaj çdo qytetet me nga pak. Por, Tirana është po them kryesuese e numrit...

**Gazetarja Anila Hoxha:** Kjo për shkak sepse ka çështjet më të mëdha dhe ka fluksin më të lartë të çështjeve apo referuar shkeljeve të pretenduara?

**Inspektori i Lartë i Drejtësisë, Z. Artur Metani:** Po, besoj që Tirana përfshin gjykata me më shumë çështje sepse është qyteti me më shumë banorë. Pa dyshim ka më shumë konflikte gjyqësore, ka më shumë situata të cilat shkojnë në procese gjyqësore, por edhe sepse ndoshta qytetarët që janë në Tiranë vijnë më kollaj në Zyrën e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, se sa vijnë nga rrethet. Natyrisht, ankesa mund të dërgohet me postë, por duke qenë në të njëjtin qytet, e bën më të thjeshtë ndoshta kontaktin me Zyrën e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë. Për këtë arsye, ne jemi duke parë forma të tjera komunikimi me qytetarët, përveç asaj që ne kemi në faqen tonë të internetit dhe lehtësirave që mundohemi t'i krijojmë edhe qytetarëve të rretheve që të paraqesin ankesat e tyre. Po mundohemi të bëjmë një program për të shkuar edhe nëpër qytete, për të evidentuar më qartë rolin e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, në mënyrë që qytetarët të kenë më shumë kontakt me Zyrën e ILD-së.

**Gazetarja Anila Hoxha:** Qytetarët ankohen më së tepërmi për shkelje në fushën e gjyqeve dhe hetimeve penale, apo për shkelje në fushën e çështjeve administrative dhe civile?

**Inspektori i Lartë i Drejtësisë, Z. Artur Metani:** Është kjo e dyta, pra më shumë ankesa kanë për çështje të gjyqeve civile dhe administrative. Por, pa dyshim ka një numër të madh edhe për gjyqe penale. Ka një numër të konsiderueshëm ankesash, rreth 50, që vijnë nga njerëz që vuajnë dënimin në institucionet e burgimit. Por, dinamika më e madhe vjen për çështje civile dhe administrative.

**Gazetarja Anila Hoxha:** Dhe meqë jemi tek çështjet penale, ju keni propozuar, dhe mbase miratuar, disa masa sa i takon gjyqtarëve dhe prokurorëve për lirimet e parakohshme. Si e gjetët ju sistemin e drejtësisë në këtë fushë? Çfarë konstatuat?

**Inspektori i Lartë i Drejtësisë, Z. Artur Metani:** Në momentin që është zgjedhur Inspektori i Lartë i Drejtësisë në janar të vitit 2020, pa dyshim ky ishte sensibiliteti më i madh i shoqërisë në atë kohë, sepse pati disa raste të lirimit para kohe me kusht të disa individëve nga institucionet e burgimit dhe për këtë arsye, vendimi i parë që mori Inspektori i Lartë i Drejtësisë në atë kohë ishte inspektimi i dosjeve të lirimit para kohe me kusht, në kuadër të një inspektimi të madh tematik sepse u prekën të gjitha gjykatat dhe prokuroritë ku ka institucione paraburgimi dhe burgimi. Ne propozuam disa masa. Ndër to ishin edhe masat për shkarkimin e 3 magjistratëve. Këto masa vazhdojnë sepse edhe sot ka magjistratë që i kemi nën hetim. Një hetim është

përfunduar dhe është dërguar për procedim në KLGJ. Kështu që është një gjë, që ne e kemi parë me shumë vëmendje. Nuk është as për ta evidentuar si sukses, nuk është as për ta evidentuar me ndonjë konsideratë. Është një proces normal pune i ILD-së dhe është mesazh i qartë për këdo magjistrat, që ILD nuk është një çekan mbi kokat e tyre, por nuk do tolerohet asnjë paligjshmëri nga ana e magjistratëve. Këtë e kam thënë që në intervistën e parë dhe këmbëngul ta them përsëri.

**Gazetarja Anila Hoxha:** Gjatë këtij inspektimi tematik a gjetët ju një sistem drejtësie që u hapte dyert për lirime të parakohshme individëve të konsideruar të rrezikshëm?

**Inspektori i Lartë i Drejtësisë, Z. Artur Metani:** Ishte një fenomen që po ndodhte dhe për këtë arsye u morën masa ndaj magjistratëve konkretë, të cilat u konkretizuan me propozime për shkarkime tek Këshillat. Është një proces për të cilin s'dua të flas sepse është një proces që vazhdon në KPA, pra në Kolegjin e Posaçëm të Apelimit. Për këtë arsye nuk do doja të përfshihesha në komente të tjera në këtë proces, por faktet flasin vetë.

**Gazetarja Anila Hoxha:** A ka më kërkesa pas inspektimit, të individë të këtij zhanri po e quaj, të rrezikshëm, që vazhdojnë të kërkojnë lirim para kohe me kusht? Pra a ka dhënë efekt inspektimi i ILD-së?

**Inspektori i Lartë i Drejtësisë, Z. Artur Metani:** Kërkesa... Unë nuk mund ta di nëse ka kërkesa sepse nuk më vijnë. Kërkesat i drejtohen gjykatave, por fakti është se ne nuk kemi asnjë informacion, që të jenë liruuar njerëz për këtë institut të së drejtës.

**Gazetarja Anila Hoxha:** Deri diku pra gjyqtarët e kanë marrë mesazhin dhe prokurorët?

**Inspektori i Lartë i Drejtësisë, Z. Artur Metani:** Edhe njëherë, ky është një proces pune dhe nuk është as për konsideratë dhe as për sukses ose jo. Ky është proces pune normal i institucioneve publike dhe vlerësoj se edhe magjistratët kështu po e kuptojnë.

**Gazetarja Anila Hoxha:** Aktualisht, po kryen ILD-ja një inspektim të caktuar me tematikë të caktuar?

**Inspektori i Lartë i Drejtësisë, Z. Artur Metani:** Po, sot kemi dy inspektime tematike, që besoj do i përpunojmë brenda një kohe shumë të shkurtër. Kanë të bëjnë me masat e ndërmarra nga disa prokurori dhe gjykata për armëmbajtje pa leje, pra për masat e sigurimit. Edhe një vendim tjetër për inspektim tematik për çështjet e zbatimit të udhëzimeve me karakter të përgjithshëm, të Prokurorit të Përgjithshëm.

**Gazetarja Anila Hoxha:** Megjithatë, ILD është duke punuar deri diku me një staf të cunuar... A keni depozituar ju kërkesa në mënyrë që të zgjerohet gjithë organigrama e ILD-së dhe natyrisht për sa kohë ju kontrollini të gjithë drejtësinë në vend, me 8 inspektorë mund të quhen edhe të pamjaftueshëm?

**Inspektori i Lartë i Drejtësisë, Z. Artur Metani:** Po, ne në organikë e kemi numrin e inspektorëve 26. Pra, në institucion duhet të ketë 26 inspektorë; gjyqtarë, prokurorë dhe jo magjistratë. Aktualisht kemi 8. Natyrisht, 26 nuk krahasohet me 8 për shkak të ngarkesës së punës. Për këtë arsye prej 16 muajsh tashmë, unë kam bërë një propozim për ndryshime ligjore të paraqitur në Ministrinë e Drejtësisë, por edhe në Komisionin e Ligjeve, për të ulur kriteret e kandidimit për ata, që dëshirojnë të jenë pjesë e ILD-

së si inspektorë magistratë. Unë e kuptoj që ka një debat, pra mund të jetë debat ligjor, sepse është një zgjedhje ligjore, por nga ana tjetër kjo është një situatë që ka nevojë për zgjidhje. Nëse nuk do të ulim kriteret për gjyqtarët, që dëshirojnë të vijnë si inspektorë këtu, atëherë ç'do bëjmë, si do t'i thithim edhe ata pak gjyqtarë që kanë mbetur në sistem, deri sa të mbushen gjykatat me gjyqtarë?! Pra, kjo është një dilemë e të gjithë sistemit, por nga ana tjetër është një gjë, që ka nevojë për zgjidhje, ka nevojë për ta trajtuar dhe për t'i dhënë një zgjidhje.



**Gazetarja Anila Hoxha:** Keni marrë një zgjidhje ndërkohë, një përgjigje?

**Inspektori i Lartë i Drejtësisë, Z. Artur Metani:** Jo.

**Gazetarja Anila Hoxha:** Dhe kjo natyrisht ndikon në efektivitet, çfarë sjell më pas?

**Inspektori i Lartë i Drejtësisë, Z. Artur Metani:** Ajo që druham, edhe nuk dua, është që të krijohet përshtypja se mund të punohet edhe me 8 inspektorë... Nuk punohet me 8 inspektorë! Njerëzit po lodhen, se duan t'i përgjigjen qytetarëve. Njerëzit po lodhen se duan t'i përgjigjen çdo detyrimi që një institucion publik ka, por nga ana tjetër ka disa kufij për ngarkesën e punës. Pa dyshim që qytetarët, media e gjithë të tjerët, nuk duan t'ia dinë se sa ngarkesë ka inspektori apo Inspektori i Lartë i Drejtësisë, duan zgjidhje. Për këtë arsye balanca e këtyre vështirësive duhet të gjejë një zgjidhje në mos ligjore, një zgjidhje praktike.

**Gazetarja Anila Hoxha:** Cili do të jetë hapi tjetër pas këtij propozimi për ndryshime për të ulur deri diku kriteret që janë vendosur dhe që janë të ngurta mesa po kuptoj, për sa kohë nuk keni marrë një përgjigje? Do të bëni një propozim të dytë?

**Inspektori i Lartë i Drejtësisë, Z. Artur Metani:** Propozimi është ende në Kuvend, pra në Ministrinë e Drejtësisë dhe Kuvend. Nuk e di se si do procedojë Ministria e Drejtësisë dhe Kuvendi. Shpresoj që të procedohet shpejt, të paktën të shtrohet në diskutim realisht profesional kjo çështje. E dyta, në varësi të zgjidhjes që do na ofrojë Kuvendi, do fillojmë të marrim masa për të gjetur zgjidhje, për evadimin e të gjithë kësaj ngarkese. Është e rëndësishme që ta them, që rreth 4500 ankesa janë shumë dhe në këtë 4500, siç e thashë përfshihet një grup i madh ankesash të prapambetura. Ato janë shumë të rëndësishme, e para nuk dua të kalojnë afatet e parashkrimit. Të gjithë inspektorët po i trajtojnë me prioritet, që të mos kalojnë afatet apo të digjen ankesat për shkak të kalimit të afatit, të parashkrimit. Por, kjo është një gjë që po ndodh, në kuptimin që ne po mundohemi të trajtojmë çdo ankesë, por është një ngarkesë e madhe, që së përballojmë dot, pra trajtimi i ankesave në kohë. E dyta, duan zgjidhje qytetarët. Pra, e kanë paraqitur ankesën para 5 viteve dhe nuk është normale për një institucion publik, të mos i kthejë një përgjigje qytetarit, të paktën pas 5 viteve. E treta, që është e rëndësishme gjithashtu, jam munduar, edhe pse janë ankesa të vjetra, të procedojmë magistratë edhe për këto ankesa të vjetra, për t'i kujtuar kujtdo, që nuk harrohet asgjë.

**Gazetarja Anila Hoxha:** Faleminderit për intervistën!

Mars 2022

Të gjitha të drejtat e rezervuara Inspektori i Lartë i Drejtësisë

© ILD



## KONTAKT ILD

WEB: [ild.al](http://ild.al)

EMAIL: [info@ild.al](mailto:info@ild.al)

ADRESA: Bulevardi "Dëshmorët e Kombit",  
Godina nr.13 Tiranë, Shqipëri



[Inspektori i Lartë i Drejtësisë Artur Metani](#)



[Inspektori i Lartë i Drejtësisë](#)



Spot prezantues ILD  
Prezantimi i Inspektorit të Lartë të Drejtësisë  
[youtube.com](https://www.youtube.com)

*[Kliko](#) për të ndjekur spotin prezantues të ILD*